



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo- Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni Pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 12

Prishtinë, më 23.01.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Igor Simiq dhe Bilall Sherifi.

**Munguan:** Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Glauk Konjufca, Agim Aliu dhe Shkumbin Demaliaj.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Valbona Bytyçi, Agjencia e Lajmeve Ekonomike Online; Behxhet Shala, KMLDNJ; Afërdita Fejzullahu, Kallxo.com; Arbisa Shefkiu, Epoka e Re; Blerinë Ukshini dhe Rezarta Delibashzade D4D; Luljeta Aliu; Elfije Boletini, Telegrafi.com; Dibran Istrefi, Klan Kosova; Sanije Berisha, OSBE; Shefki Kastrati, NDI; Shahadije Bikliqi, KTV; Edita Kusari, EUSR/EUO; Diana Berisha, IKD; Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office dhe Drini Çano Ministria e Financave.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

**Nga stafi mbështetës:** Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2018;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme;

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034;
5. Shqyrtimi i kërkesës të znj. Luljeta Aliu;
6. Të ndryshme.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua me ndryshime, duke u zhvendosur pika 5 në pikën 2 dhe anasjelltas.*

## 2. Shqyrtimi i kërkesës të znj. Luljeta Aliu

**Albulena Haxhiu, kryetare,** paraqiti për shqyrtim kërkesën e znj. Luljeta Aliu dhe e ftoi ta marrë fjalën.

**Luljeta Aliu:** Fillimisht dua të theksoj kjo nismë ka për synim ndryshimin, qartësimin dhe plotësimin e Ligjit për Familje, duke pas parasysh analizat e shumta ekzistuese rreth hendekut mes të drejtave ligjore dhe zbatimit të tyre të mangët në praktikën ligjore që do të duhej të rregullohej sepse do të rregullohej edhe mirëqenia e gjysmës së popullatës. Po ashtu tha se paqartësitë në nenet e këtij ligji po bëjnë që të mos interpretohet siç duhet nga gjyqtarët dhe kështu po dëmtohen palët që në shumtë e rasteve janë gratë. Ky rregullim nuk ka të bëjë vetëm me të drejtat e grave. Ka pika ka çështje që duhet t'i rregullojmë. Gjithashtu do duhej të rregullohej edhe mirëqenia e gjysmës së popullatës andaj edhe ju keni përgjegjësi sepse ato ju kanë votuar ku është edhe në interes të fëmijëve sepse ata që pësojnë më së shumti nga divorcet janë fëmijët. Synimi kryesor me këtë propozim është që të parandalohet dhuna ekonomike ndaj grave, sepse gratë janë të varura ekonomikisht në mënyrë të pa drejtë nga burrat. Ndarja e pasurisë, pronës pas martesë bëhet shpeshherë në favor të burrit duke e ditur që 90 % e pronave janë të regjistruara në emër të burrave dhe vetëm 10% e pronave në emër të grave. 42 % e grave i nënshtrohen dhunës dhe kjo dhunë sipas hulumtimeve nuk bëhet për shkak të papunësisë, por në raste kur burri është i punësuar e gruaja jo. Neni kryesor është 47, i cili përcakton ndarjen e pasurisë së përbashkët ku thuhet se pasuria e përbashkët ndahet në pjesë të barabarta, nëse ndryshe nuk janë marrë vesh pa marrë parasysh a ka punuar a jo gruaja. Unë besoj se nëse neni 47 duhet të saktësohet me një paragraf tjetër si vijon *'se puna në familje marrja me fëmijë e me shtëpi është e barasvlershme me punën fitimprurëse të burrit jashtë shtëpisë'*. Ajo çfarë po ndodh është se gjyqtarët po vendosin në mënyrë arbitrare se si duhet të ndahet pasuria e përbashkët. Pjesa tjetër për shembull neni 305 i ligjit për familjen i cili ka një gabim teknik, e cila thotë se në nenin 306 në paragrafin 3 në këtë nen nuk ka paragraf numër tre duke pohuar se kjo po keqpërdoret sepse e ka lidhur nenin 305 me 302 dhe ndër lidhja duhet të jetë neni 305 me nenin 306. Termi ushqimi është i gabueshëm sepse nuk dihet për çfarë përdoret. Po përdoren gjëra që po lejojnë të keqpërdoret ligji dhe duhet të shihet te neni termi ushqimi me *'alimentacion'*. Po ashtu znj. Aliu përmendi që duhet të bëhen ndryshime të disa neneve në procedurë kontestimore të cilat kanë të bëjnë me sigurimin e kërkesëpadisë (nenet 296-318).

**Kryetarja** tha se do ta përkrahë këtë nismë që ju e keni paraqitur në komision duke e ditur që situata është alarmante në këtë drejtim dhe kjo ndoshta për shkak të mendësisë patriarkale dhe me sa po shihet Gjykatat e kanë problem të vendosin drejt në rastet e ndarjes së pasurisë, ushqimit, alimentacionit. Me tej znj. Haxhiu shtoi se beson që edhe komisioni do ta përkrahë këtë nismë

pikërisht me gjendjen që sot po ballafaqohen gratë duke pohuar se ka edhe raste të veçanta që edhe burrat diskriminohen, prandaj gratë dhe burrat të jenë të barabartë në shoqëri.

**Arben Gashi** tha se meqenëse ju këtë nisëm e keni nisur privatisht më duhet të informoj se nismat legjislative që merren nga qytetarët e kanë një rrugë të vetme, por kjo nismë nuk është praktikë në komisione parlamentare. Ndërkohë, shqetësimet që ju i paraqitët janë reale, që gratë përballen me këto probleme, por ka edhe raste që edhe burrat kanë probleme. Ky material që ju e keni dërguar konsiderohet vetëm material studimor. Ajo çfarë do të mundemi të bëjmë ne do ishte të merrnin një nismë si komision sipas procedurave ligjore që të bëhet ndryshim plotësimi i këtij ligji. Po ashtu, ne, si komision, ndoshta mund të kërkojmë nga zyra për hulumtime në Kuvend që të shohim sa janë të sakta këto gjetjet tuaja dhe më pas ne mund të propozojmë Kuvendit në seancë plenare që t'i kërkojmë Qeverisë për t'i rishikuar këto ligje.

**Korab Sejdiu** tha se është përpjekje e madhe për një individ që ka gjetur mënyrën për të ardhur në Kuvend sepse çështja që ju ngrehni është çështje mentaliteti. Unë besoj që fryma e propozimit tuaj meriton një trajtim serioz, jo vetëm e komisionit, por edhe Kuvendit. Ne duhet të kemi një strategji gjithëpërfshirëse dhe më të gjerë për t'i adresuar këto probleme, përveç saktësismit të disa neneve specifike në legjislacionin që është në fuqi.

**Bilall Sherifi** tha se jemi duke lëvizur nga një shoqëri komunitare në një shoqëri individuale duke e bërë që gruaja të jetë më e rrezikuar për shkak të pozicionit që ka në shoqëri. Duke e pasur parasysh këtë infrastrukturën ligjore ta përmirësojmë edhe më shumë në mënyrë që kur të ndeshemi me probleme të tilla ligji të jetë edhe më qartë. Po ashtu z. Sherifi tha se do ta kesh votën time në kuadër të komisionit dhe të inkurajohen njerëzit që kanë nisma individuale.

**Sami Kurteshi** tha se e përkrah këtë nismë legjislative sepse është një përpjekje për një kalim cilësor dhe ajo është baras vlefshmëria e punës publike dhe private në familje.

**Igor Simiq** tha se si person që ka punuar dhe vepruar mbi 6 vjet në çështjet që lidhen me te rinjtë, dhe promovimit e të drejtave të tyre, e di se sa ky problem është prezent te kjo pjese e shoqërisë. Në vitin 2015 kanë qenë 1040 raste të dhunës në familje, të regjistruara nga policia e Kosovës, ndër këto raste 18 viktima kanë qenë fëmijët. Ndërsa në vitin 2016 janë 1230 raste që tregojnë një rritje të theksuar. Kjo nuk do të thotë që njerëzit në vitin 2016 kanë qenë më të dhunshëm këtë vit se vitin paraprak, por ka bërë që përmes angazhimit të OJQ-ve gratë të fuqizohen dhe që dhunën ta raportojnë. Interpretimi i çfarëdo ligji nuk do të parandalojë dhunën në familje. Ne na duhet bashkëpunimi ndër-sektorial dhe edukimi i të rinjve në fazat sa më të hershme. Këtu nuk duhet bërë dallimi mes edukimit të fëmijëve të gjinisë mashkullore apo atyre femërore. Në të gjitha shoqëritë në botë, si edhe në Kosovë, gratë përbejnë shumicën e popullsisë së atyre shoqërive, në përmasa 49 me 51 në favor të grave. Kur të shikoni cilindo institucion, dhe jo vetëm në Kosovë por edhe në gjithë botën, përqindja e punësimit të grave është shumë i ulët. Dhe ajo që u theksua me herët se arsytet ekonomike janë nga shkaqet kryesore të dhunës në familje, pajtohem plotësisht, dhe kjo jo vetëm si shkak i pasojës, por edhe si shkak që gratë durojnë dhunën. Mendoj që kjo është një nga temat që meriton vëmendjen e të gjithë neve, posaçërisht kur sot këtu kemi vetëm një përfaqësuese të gjinisë femërore, derisa gjithë të tjerët jemi meshkuj dhe është detyrë e

jona që përmes diskriminimit pozitiv që t'u përgjigjemi kërkesave. Këtë që ju keni bërë është për t'u përshëndetur dhe ajo çfarë mund të them, në emrin tim dhe të partisë që përfaqësoj, për të gjitha këto kërkesa që keni prezantuar do keni mbështetjen time dhe 10 votat e partisë tonë.

**Kryetarja** tha se nuk ka shkelje të procedurave duke e potencuar se çdo shkresë që vjen gjithmonë e paraqes në Komision.

*Anëtarët e Komisionit, gjatë diskutimit të tyre shfaqën qasje pozitive ndaj kësaj kërkesë dhe theksuan faktin se këto janë shqetësime reale dhe se Komisioni do të shikojë mundësinë e ndonjë nisme legislative, apo ndonjë formë tjetër për të rregulluar çështjet që u paraqitën si shqetësuese në këtë ligj.*

### **3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-005 për tatimin në Pronën e Paluajtshme**

**Kryetarja** paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-005 për tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe tha që nuk kam ndonjë problem në aspektin kushtetues, mirëpo qëndrimi jonë si Grup Parlamentar është që mos të përkrahet ky projektligj dhe shqetësimet tona do t'i shprehim në seancë plenare dhe i ftoi anëtarët që të deklarohen në lidhje me këtë projektligj.

*Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni, me 1 për 2 kundër dhe 3 abstenim, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

#### **Rekomandim**

Komisioni nuk e përkrah raportin me amendamente në Projektligjin nr. 06/-005 për Tatimin në Pronën Paluajtshme

### **4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034.**

**Kryetarja** paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034 dhe theksoi që është me shumë probleme duke pohuar se ka ardhur raporti nga zyra për standardizim që e konteston këtë nismë formale-juridike. Shpreh shqetësimin që është regres për të gjithë përpjekjen e punës sonë për të forcuar sistemin e drejtësisë. Në nenin 1 Kryeprokurorit të shtetit i shtohet një kompetencë "përfshirë hetimin dhe ndjekjen penale, si pjesë e ushtrimit të funksioneve

prokuroriale”, duke konsideruar që është ndërhyrje në punën e prokurorit të shtetit. Tendenca për ta fuqizuar kryeprokurorin është e pa pranueshme për faktin se ne kemi nevojë ta forcojmë edhe Këshillin Gjyqësor edhe Prokurorial dhe jo vetëm një individ, i cili mund të jetë i shantazhushëm i kërcënueshëm, i korruptuar duke mos folur me emra të përveçëm, por në përgjithësi për individin. Po ashtu në nenin 1 thotë i cakton prokurorët në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, sipas nevojave urgjente dhe ngarkesës me lëndë në këtë prokurori, e cila është kompetencë e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe nuk bën që të dobësohen kompetencat e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe në anën tjetër të fuqizohen kompetencat e Kryeprokurorit të Shtetit.

**Arben Gashi** tha se bëhet fjalë për dy koncepte, Kryeprokurori i Shtetit, si prokuror dhe si administrator i sistemit, pra me këtë nen i jepen kompetenca Kryeprokurorit të Shtetit edhe si prokuror. Ndaj si princip mendoj që nuk mund të jetë shumë problem përderisa e administron sistemin sepse fundja Kryeprokurori është prokuror. Z. Gashi propozoi që të kërkohet nga zyra për Hulumtime e Kuvendit që të shohim edhe praktikën e vendeve të tjera se si e kanë të rregulluar rolin e Kryeprokurorit, me vende që janë karakteristike si ne, territori, numri i banorëve, traditën institucionale për të parë se si e kanë të zgjidhur këtë çështje. Mendoj se është çështje përtej politizimit ditor më me rëndësi është për të parë funksionalitetin e prokurorisë. Ndërsa te caktimi i rasteve sipas nevojave të urgjencës mendoj se ka logjikë dhe mua më duken të pranueshme nëse janë në pajtim me sistemin.

**Kryetarja** tha se shqetësimi tjetër është te neni 2 i projektligjit, sepse nuk mund të ketë barazim kriteresh të prokurorëve në mes prokurorëve special dhe prokurorëve nëpër prokuroritë themelore. Po ashtu neni 3 është problematik, sepse paragrafi 4 i nenit 11 të Ligjit të ndryshuar, fshihet nga teksti që ka të bëjë me veprimtarinë profesionale të prokurorëve jashtë orarit të punës, por nuk mund të tejkalojnë 25 % të pagës bazë që do të thotë se prokurorët mund të paguhen sa të duan dhe jo si është tani me ligjin aktual gjë që është e papranueshme. Ndërkaq neni 3 thotë se paragrafi 2 i nenit 12 të Ligjit të ndryshuar, fshihet nga teksti i cili thotë ‘statusi i stafit administrativ i nënshtrohet parimit të shërbimit civil dhe do të rregullohet me ligj të veçantë’ dhe natyrshëm lind pyetja çfarë do të bëhet me stafin administrativ, andaj Komisioni do duhej t’i dërgonte rekomandim seancës që mos të përkrahet ky projektligj.

**Arben Gashi** propozoi që të ftohet propozuesi në komision që të sqarojë se çfarë ka dashur të thotë me këtë ndryshim- plotësim të projektligjit në mënyrë që edhe ne ta kemi të qartë për të marrë vendim dhe më pas i rekomandojmë seancës.

**Korab Sejdiu** tha se e përkrah z. Gashi në propozimin tij që të ballafaqohemi me propozuesin që të kuptojmë më thellësisht qëllimin edhe pse mund ta kuptoj arsyen apo qëllimin. Pritjet janë jashtëzakonisht të mëdha sa i përket kryeprokurorit në luftimin e krimit, e veçanërisht të korrupsionit. Në nenin 1, pikën 1 dhe 2 adresohet këto çështje menaxhimi i stafit dhe prokurorëve dhe lëvizja e tyre, varësisht se ku ka nevojë sepse është e vërtetë që në disa degë gjykatave themelore ka më pak punë e në disa të tjera janë të ngarkuara me shumë lëndë dhe kjo është një mundësi e mirë për të lëvizur stafi për të cilën është edhe brengë e Kryeprokurorit që të ketë mundësi për lëvizur stafin e tij, por edhe të kenë mundësi ligjore për t’i ndjekur rastet. Ne, si komision, duhet të gjejmë balancën në mes të fuqizimit të tepërt të kryeprokurorit edhe dhënies së mundësisë së lirë që ai t’i kryej funksionet e tij në përputhje me pritjet që janë shumë të larta karshi kryeprokurorit dhe natyrisht stafit të tij të cilët përfshinë prokurorët dhe stafin ndihmës.

**Sami Kurteshi** tha se mendoj që përvoja në Kosovë nuk është e zakonshme, sepse në secilin vend krijohen sisteme për ndarjen dhe marrjen e lëndëve. Pajtohem plotësisht që Kryeprokurori i ka dy role; njërin e ka të prokurorit dhe tjetrin atë të menaxherit për të cilën duhet të bazohen në një ligj. Duhet të ketë një institucion që konstaton një prokuror, ka bërë shkelje të rënda në punën e tij dhe kjo i ka kalohet sipas rregullores kryeprokurorit, por nëse në çdo moment kryeprokurori të vendosi t'ia marrë lëndën sepse i duket që nuk po e bën mirë, kjo paraqet një rrezik shumë të madhe kur dihet se si po caktohen prokurorët e kryeprokurorët në Kosovë. Në lidhje me këtë shqetësim z. Kurteshi përmendi rastin 'Dehari' ku kryeprokurori i prokurorisë themelore në Prizren, Sylë Hoxha thuaja se e ka përjashtuar prokurorin e çështjes Metush Biraj duke mos e lënë as në paraqitje publike, as në trajtimin e lëndës dhe as në interpretimin e rastit në përgjithësi, pa nxjerrë asnjë vendim se prokurori i rastit ka bërë shkelje të rënda. Mendoj se kjo detyrë mund t'i lejohet, kjo mundësi kryeprokurorit, por kjo të jetë e bazuar në ligj, e jo kjo mundësi t'i lejohet arbitraritetit individual. Ndërsa sa i përket heqjes së përqindjes është shqetësuese se shumë prokurorë dhe gjyqtarë më shumë i gjen duke dhënë mësim në Universitete, sesa në vendin e tyre të punës edhe pse shumica prej tyre mbase nuk e kanë kualifikimin e duhur për të dhënë mësim në Universitet. Heqja e statusi të stafit të administratës nga shërbimi civil është shumë e rrezikshme sepse ajo i lihet të rregullohet me ligjin të punës apo të rregullohet me ndonjë rregullore të brendshme që mund të sjellë probleme.

**Bilall Sherifi** tha se këtu po bëhet fjalë që të përfshihet kryeprokurori me ligj në hetim dhe ndjekjen penale si pjesë e ushtrimit të funksionit si të gjithë prokurorët kur i caktohet një rast dhe Kuvendi vendos se a do të jetë Kryeprokurori vetëm administrator apo do të merret edhe me çështjen e rasteve ashtu si është në këtë projektligj. Ndërsa sa i përket çështjes së administratës, kur shuhet një dikaster e rregullon Ligji për Shërbim Civil sepse nuk mund të përjashtohet nga puna askush nëse shuhet një dikaster cilit do institucion publik.

**Arben Gashi** sërish e përsëriti propozimin e tij për hulumtim në mënyrë që të mos dalim me një rekomandim refuzues pa i qartësuar të gjitha dilemat që i kemi për këtë projektligj. Po ashtu të ftojme në komision edhe propozuesin, i cili në këtë rast është ministri i Drejtësisë, që të arsyetojë propozimin e vet para komisionit.

*Pas diskutimeve dhe një sërë vërejtjesh që u paraqitën në lidhje me këtë Projektligj, komisioni vendosi që të kërkojë sqarime nga ministri i Drejtësisë, si propozues i këtij projektligji dhe po ashtu të kërkohet nga zyra për Hulumtime Kuvendit informacione shtesë se si e kanë të rregulluar rolin e Kryeprokurorit vendet e tjera të rajonit, por edhe më gjerë.*

## **5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2018**

**Kryetarja** paraqiti për shqyrtim Planin e Punës së Komisionit për vitin 2018 i bazuar kryesisht në strategjinë legjislative të Qeverisë. Mendoj se duhet të fokusohemi si komision në mbikëqyrjen e ligjeve për zbatueshmërinë e tyre, sepse kemi shumë të tilla që nuk po zbatohen, por po ashtu të marrim nisma legjislative si p.sh. të marrim nisëm legjislative për ndryshimin e ligjit për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë dhe të ligjit për hetim parlamentar dhe ftoi anëtarët që të marrin fjalën nëse kanë vërejtje.

**Arben Gashi** propozoi që kjo pikë rendit të ditë të shtyhet për mbledhjen e radhës, meqenëse plani i punës është shumë i rëndësishëm dhe duhet më tepër kohë që të trajtohet plani i punës, sepse vendoset për gjithë vitin puna e komisionit. Po ashtu nëse është e nevojshme të marrim edhe propozime shtesë nga organizatat që e mbështesin punën e Komisionit.

*Meqenëse nuk pati diskutim, anëtarët e komisionit u pajtuan që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme të komisionit.*

## **6. Të ndryshme**

### **A. Njoftim**

**Kryetarja** i njoftoi se KDI ka kërkuar që ne, si komision, t'i japin leje, që kjo të bëjë hulumtim parlamentar për Marrëveshjet e arritura në Bruksel, të cilat hulumtime të mund të shërbejnë edhe punën e komisionit.

**Arben Gashi** tha se KDI është e mirëseardhur të bëj hulumtim, por ky hulumtim nuk është i kërkuar nga komisioni, sepse nuk mund të bartim kompetencat e komisionit te një organizatë joqeveritare. Në momentin që mund ta sjellin raportin si informatë ne mund ta shqyrtojmë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:55.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

---

**Albulena Haxhiu**